

**Shoqëria “Lucror Financial Services” Sh.p.k.**  
**Regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NIPT M11505023B**

---

**VENDIM**  
**i Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë**  
**“Lucror Financial Services” Sh.p.k.**

Ky vendim u mor sot me datë 16/07/2021, në selinë e shoqërisë “Lucror Financial Services” Sh.p.k. Në këtë mbledhje marrin pjesë ortakët e shoqërisë që përfaqësojnë 100% të kapitalit të shoqërisë:

- **Wealthy Bee Sh.p.k.**, Ortak i Shoqërisë
- **Z. Petraq Milo**, Ortak i Shoqërisë
- **Z. Akil Kraja**, Ortak i Shoqërisë

Rendi i ditës është:

- Ndryshimi i objektit të veprimtarisë së shoqërisë;
- Të tjera eventuale.

Në bazë të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, dhe në bazë të Statutit të Shoqërisë, ortakët e shoqërisë

**VENDOSËN:**

1. Ndryshimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë si vijon.

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

1) Shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë:

- a) për të gjitha format e kredidhënies
- b) për faktoringun
- c) për qiranë financiare
- d) për shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave
- e) për ofrimin e garancive dhe marrjen e angazhimeve
- f) për këmbimin valutor

si subjekt financiar jobankë / institucion financiar mikrokredie / institucion i parasë elektronike.

2) Shërbimet që mundësojnë derdhjen, transferimin apo tërheqjen e parave fizike, nëpërmjet një llogarie pagese, si dhe të gjitha veprimet e nevojshme për funksionimin e një llogarie të tillë.

3) Shërbimet që mundësojnë derdhjen, transferimin apo tërheqjen, e parave fizike ose jo, nëpërmjet llogarive apo kanaleve elektronike si faqet çeb/aplikacionet e dedikuara etj., si dhe të gjitha veprimet e nevojshme për funksionimin e një llogarie të tillë.

- 4) Ekzekutimi i transaksioneve të pagesave, duke përfshirë transferimet e fondeve në një llogari pagesash të çelur pranë ofruesit të shërbimit të pagesave të përdoruesit ose pranë një ofruesi tjetër të shërbimit të pagesave:
  - a) ekzekutimi i debitimeve të drejtëpërdrejta, duke përfshirë dhe debitimet e drejtëpërdrejta që bëhen vetëm një herë;
  - b) ekzekutimi i transaksioneve të pagesave përmes një karte pagese ose nga një pajisje e ngjashme;
  - c) ekzekutimi i transfertave të kreditit, duke përfshirë urdhër pagesat periodike.
- 5) Ekzekutimi i transaksioneve të pagesave, ku fondet janë të mbuluara nga një linjë kredie për një përdorues të shërbimit të pagesave:
  - a) ekzekutimi i debitimeve të drejtëpërdrejta, duke përfshirë debitimet e drejtëpërdrejta që bëhen vetëm një here;
  - b) ekzekutimi i transaksioneve të pagesave përmes një kartë pagese / pajisje e ngjashme ose prodhimi/promovimi i tyre;
  - c) ekzekutimi i transfertave të kreditit, duke përfshirë pagesat periodike.
- 6) Lëshimi i një instrumenti pagese dhe/ose pranimi i transaksioneve të pagesave.
- 7) Dërgesat e parave, brënda apo jashtë vendit.
- 8) Shërbimi i inicimit të pagesës.
- 9) Shërbimi i informimit mbi llogarinë e pagesës së një klienti, apo mbi llogaritë dhe transaksionet që klienti mund të ketë hapur apo kryer me palë të treta (shërbime, utilitare etj.).
- 10) Shërbimi i trajtimit të të dhënave, duke përfshirë aksesimin, përpunimin, konsolidimin dhe komunikimin mbi këto dhëna.
- 11) Shërbimi i ndërmjetësimit të biznesit, ofrimit të studimeve të tregut, të analizave ligjore, financiare dhe ekonomike.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

2. Autorizimin e Z. Glen Sakej, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. 036735796, që të kryejë procedurat e regjistrimit të këtij vendimi në QKB.

Lexuar, aprovuar e nënshkruar nga Ortakët e shoqërisë.

**Shoqëria "Lucror Financial Services" Sh.p.k.  
Asambleja e Ortakëve**

**Wealthy Bee Sh.p.k.**  
Përfaqësuar nga  
Erdi Sakej

**Petraç Milo**

**Akil Kraja**



*Erdi Sakej*  
*[Signature]*

*Petraç Milo*  
*[Signature]*

*Akil Kraja*  
*[Signature]*

**LUCROR FINANCIAL**  
**M11505023B**  
**TIRANE**